Përmirësimi i ambjentit dhe shëndetit të popullsië dhe rritja e ofertes turstike nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve rurale

3. Objektivat specifike të projektit

OS1: Përmirësimi i skemës së menaxhimit të mbetjeve rurale

OS2: Promovimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe ekonomikisht të përballueshëm të zhvillimit të turizmit rural

OS3: Përmirësimi i infrastrukturës të grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve ,

4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

- R.1 Skema e grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve rurale e zhvilluar
- R.2 Sistem tarifer ekonomikisht i qëndrueshëm i zhvilluar dhe turizem I avancuar;
- R.3 Infrastruktura e grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve e zhvilluar

Përfitues të këtij programi janë gjithë popullsia ne zonat turistike

Projekti mendohet te zgjase per nje periudhe me shume se 2 vjecare, pasi është konceptuar në formen e nje programi I cili do të mund të realizohet me dy faza. Faza e pare do fokusohet tek kryerja e studimeve dhe strategjise se ndërhyrjes dhe faza e dyte tek zhvillimi i sistemit te grumbullimit e menaxhimit te mbetjeve rurale

Kostoja e fazes së parë është përcaktuar më poshtë , kurse kostoja e fazes së dytë mund të përcaktohet vetëm pasi të këndë përfunduar studimet që do realizohen në fazën e parë.

2. Aktivitetet e projektit

Faza e Pare

Hartimi studimit për menaxhimin e mbetjeve dhe ndërgjegjësimin e popullsisë, duke përfhirë dhe studimin për kostimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë elementët e tij dhe një diferencim i tarifës së këtij shërbimi për zonën urbane dhe atë rurale në varësi të ofrimit të shërbimit.

Faza e Dyte

- Zbatimi i planit te grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve rurael
- Investime ne infrastrukturën e grumbullimit dhe përpunimit të mbetejeve
- rritja e ofertes turistike

3. Maturimi i projektit

Nuk ekziston nje studim paraprak qe ka bere një analizë të mënaxhimit të mbetjeve në rajonin e zonave turistike te Shtimes.

4. Burimet e financimit dhe partneret e implementimit

Financuesit e projektit:

- Komuna
- Donatoret
- MMPH

Projekti do te zbatohet nga:

- Komuna Shtimes
- MMPH
- PPP-ne kete rast edhe komuniteti biznesit do kyqet

5. Kostot e projektit (ne Euro)

<i>Nr</i>	<i>Aktivitetet</i>	<i>Buxheti per aktivitet</i>
•	Hartimi i studimit të menaxhimit të mbetjeve rurale	30,000
•	Hartimi i studimit të impaktit ne rritjen e aktivitetit turistik	15,000
•	Trajnim të ofruesve të shërbimeve turistike rurale për trajtim të mbeturinave	10,000
TOTALI		55,000

2 . Titulli I projektit	Pyllëzimi i Grykave dhe hapësirave turistike
Lloji i projektit	Mjedisor-Turistik
Vendodhja e projektit	Gryka e Llanishtit dhe Carraleves
Vlera e Buxhetit ne total	45.800 Euro

1. Sfondi dhe analizimi i projektit

Komuna Shtime gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshin qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra me një popullsi prej 27,288 banorë¹ me rreth 4.158 familje dhe me një dendësi popullesie 203.91 banorë / km² dhe moshë mesatare 27.62 vjeç. Në vendbanimet e komunës së Shtimes gjenden gjurmë të trashëgimisë historike e kulturore që prej kohës së neolitit, ilirëve, romakëve dhe vazhduar me ato të Perandorisë Osmane. Sipas defterit kadastral të vitit 1455 Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrrisë dhe ishte nën pushtimin osman. Në vitin 1566-74 i takonte Nahijes së Moravës me qendër në Prishtinë. Ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanxhakut të Prizrenit. Komuna Shtime ka një sipërfaqe prej 134 km² (13.450,8 ha) dhe shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, kufizohet me komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suharekës). Qendra administrative, qyteti i Shtimes është 31 km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45 km larg Prizrenit dhe 13 km nga Ferizaj.

Zonat tursitike te lartepermendura jane te lidhura me infrastrukture te mire dhe **parashikohet qe do te kete nje numer me te madh makinash qe do te levizin per vete faktin se zona e Llanishtit dhe ajo e Rances eshte nje zone e pasur me bukuri natyrore dhe nje nder zonat me perparesi zhvillimin e turizmit.**

Pyllezimi i kesaj pjese te zonave turistike me drunj halor pergjate rruges do ti jepte pamje terheqese Grykes se Llanishtit dhe zones perreth. Gjithashtu Turizmi dhe Mjedisi jane prioritetet edhe të Strategjise se Zhvillimit te tuirizmit rural, prandaj lind nevoja e përmirësimit te mjedisit natyror të rajonit si një aspekt kyç i identitetit dhe atraktivitetit të tij, sidomos duke shmangur të gjitha efektet negative në mjedis përmes aktiviteteve njerëzore.

2. Objektivi kryesor i projektit

Te kontribuojë në mbrojtjen e ambjentit dhe të eco-sistemit në Zonen Frunksionale, si dhe në mbrojtjen e jetës së banorëve nga ruajtja dhe eliminimi i zhkarjeve të tokës si rezultat i efekteve të erozionit.

3. Objektivat specifike te projektit

Objektivat specifike janë si më poshtë:

OS1: Të kontribuojë në përmirësimin e kurorës së pyjeve pergjate pjeses ne rajonin e Grykës së Llanishtit

OS2: Të kontribuojë në ndergjegjesimin e banoreve te zones perreth per rendesine e

pyllezimit dhe mbrojtjes se pyjeve dhe ndikimin e tyre ne zhvillim te gjithmbarshem turistik

4. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

1	Pastrimi, rrallimi dhe pyllëzimi në Rajonin e Grykës se Carralevës
2	Pastrimi, rrallimi dhe pyllëzimi në Rajonin e Grykës së Llanishtit
3	15 banore te trajnuar (5 banore per zone
4	300 flete palosje te prodhuara
5	150 broshura te prodhuara

5. Aktivitetet e projektit

1. Krijimi i nje komisioni me specialiste te pyjeve
2. Percaktimi i temave te trajnimeve
3. Percaktimi i pjesemarresve ne trajnim
4. Organizimi i trajnimeve
5. Pregatitje flete palosje, broshura
6. Percaktimi i zones ku do te behet pyllezimi
7. Percaktimi i llojit te drureve qe do te mbillen
8. Pregatitja e tokes per mbjellje
9. Blerja e fidaneve
10. Mbjellja e fidaneve

Projektet mendohen te zbatohen ne nje periudhe 2 vjecare

9. Maturimi projektit

Nuk eshte ndermarre nje projekt i tille ne kete zone. Ne propozim është percaktuar dhe zhvillimi i nje studimi paraprak për zonen e nderhyrjes, per pyllezimin e kesaj zone qe te vazhdoje te ruhet statusi i monumentit te natyres.

10. Burimet e financimit dhe partneret e implementimit

Projekti nuk ka financime te siguruara ende por mendohet te financohet nga burimet financiare qendrore dhe donatoret

Projekti do te zbatohet nga:

- Komuna e Shtimes
- Agjencia e Pyjeve te Kosoves.
- MMPH

- Komuniteti I biznesit

11. Kostot e projektit

Nr.	Aktivitetet	Buxheti per aktivitet
1	Krijimi i nje komisioni me specialiste te pyjeve	300
2	Percaktimi i zonave te nderhyrjes	1500
3	Percaktimi i temave te trajnimeve	300
4	Percaktimi i pjesemarrjesve ne trajnim	300
5	Organizimi i trajnimeve	1.800
6	Pregatitje flete palosje, broshura	5.000
7	Percaktimi i zones ku do te behet pyllzimi , percaktimi i llojit te drureve qe do te mbillen	1.600
8	Pregatitja e tokes per mbjellje	10.000
9	Blerja e fidaneve	20.000
10	Mbjellja e fidaneve	5.000
	TOTALI	45, 800

3.Titulli i projektit	<i>Ngritja e zyrës së turizmit si zyrë me një ndalesë për investitore dhe turistë potencial</i>
Lloji i projektit	<i>Permirësim i shërbimit të Komunes ndaj qytetarëve</i>
Vendodhja e projektit	<i>Komuna Shtimes</i>
Vlera e Bugjetit në total	<i>73,000 Euro</i>

1. Sfondi dhe analizimi i projektit

Gjatë dekadës së fundit, reformat e ndërmara nga Qeveria Qëndrore (regjistrimin e biznesit, licencave dhe lejeve të reformave, reforma autorizimit, etj) në mënyrë që të krijojë një ambient miqësor dhe jo-burokratik si për biznesin dhe qytetarët, ka prekur dhe janë përfshirë edhe nën kompetencat e qeverisjes vendore. Është evoluar në mënyrë të konsiderueshme në drejtim të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe zgjidhjet e tjera inovative (ex: zyrat me një ndalesë) në ofrimin e shërbimeve publike dhe menaxhimin e brendshëm, por përdorimi i IT dhe zgjidhjeve të reja në qeverisjen vendore është mjaft i kufizuar. Komuna e Shtimes deri më sot me gjithë avancimet e medha nuk ka mundur të ngrëjë një strukturë të tillë e cila ka si qëllim ofrimin e shërbimeve për veprimtari të mirefillte turistike dhe investime në këtë sektor.

Në Komune të Shtimes, nëpërmjet vendosjes në dispozicion të tyre të një stafi të specializuar i cili do të bëjë të mundur që kërkesat dhe problemet që ata kanë të marrin zgjidhje sa më të shpejtë. Me ndërtimin e kësaj zyre evitohet humbja e kohës nga investitorët dhe qytetarët dhe bëhet e mundur rritja e cilësisë së shërbimit që ata do të marrin.

2. Objektivi specifik i projektit

Krijimi i infrastrukturës së nevojshme me resurse me qëllim lehtësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj investitoreve dhe qytetarëve me qëllim ofrimin në kohë të shkurtër dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

3. Rezultatet e pritura dhe treguesit e projektit

R1: Krijimi i mjediseve fizike moderne të ofrimit të shërbimit ndaj investitoreve në fushën e turizmit rural dhe publikut

R3: Menaxhim i përmirësuar i proceseve të punës dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj komunitetit

R4: Instalimin e një sistemi të integruar të informimit dhe komunikimit me investitorët potencial dhe publikun

- Zyra me një ndalesë do të shërbejë gjithë investitorëve dhe qytetarëve të interesuar për aktivitete turistike në Komunën e Shtimes

-Nga ndërhyrja do të përfitojë Komuna e Shtimes dhe investoret. E para me terheqjen e investimeve e te dytet me shpejtesi te realizimit te ideve te tyre turistike.

4. Aktivitetet e projektit

- 1 Zhvillimi i nen projektit të detajuar për dizajnimin e zyres per sherbimem turistike rurale me nje ndalese
- 2 Krijimi i kushteve te punes në ambjente ekzistuese
- 3 Pajisja me kompjutera dhe pajisje zyre
- 4 Instalimi i programeve softwarike për kominikimin e integruar
- 5 Trajtime te ndryshme per stafin e Komunes te parapreper zyren
- 6 Prodhimi i materialeve informuese fletepalosje, guida etj.

5. Maturimi i projektit

Nuk ekziston projekt ideja e zhvilluar nga Komuna e Shtimes

6. Burimet e financimit dhe partneret e implementimit

Projekti do zbatohet nga Komuna e Shtimes

7. Kostot e projektit (euro)

Nr.	Aktivitetet	Buxheti
1	Zhvillimi i nen projektit të detajuar për dizajnimin e zyres per sherbimem turistike rurale me nje ndalese	3,000
2	Krijimi i kushteve te punes në ambjente ekzistuese	5, 000
3	Pajisja me kompjutera dhe pajisje zyre	10, 000
4	Instalimi i programeve softëare për kominikimin e integruar	5, 000
5	Trajtime te ndryshme per stafin e Komunes dhe ZNJ	15, 000
6	Prodhimi i materialeve informuese fletepalosje, guida etj.	5, 000
TOTALI - ne Euro		43,000

2. LISTA E PJESEMARRESVE NE PUNETORI



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**



GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

Ne kuader te Projektit "Per Hartimin e projekteve për 3 Zona Turistike
a) Llanisht-Topillë-Devetak, b) Carralevë-Rancë dhe c) Dugë-Karaqicë-Pjetërshticë

ORGANIZON

**PUNËTORI ME PALËT E INTERESIT PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË 3 ZONAVE TURISTIKE-
8-9 TETOR 2016, BREZOVICE**

Data: _____ 2016_Dita _____

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Telefoni	E - mail	Nënshkrimi
1	Ibrahim Krasniqi	Menaxher Projekti	044666217	gdi.shpk@gmail.com	
2	Fadil Millaku	Expert i Projektit	039432361	fmillaku@hotmail.com	
3	Gentrit Krasniqi	Expert i Projektit	049967543	Genti@gmail.com	
4	Sabri Çerkini	Drejtor për ZHE	044287346	sabri.cerkini@gmail.com	
5	Mehdi Salihu	Drejtor për PUKGJ	044747066	mehdisalihu@hotmail.com	
6	Fatmire Ferati	Drejtor për KRS	044228533	fatmireferati939@gmail.com	
7	Musa Baftiu	Drejtor për SHMS	044205663	musabaftiu_555@hotmail.com	
8	Safet Brahimi	Koordinator i projektit	044228487	safet.brahimi@hotmail.com	
9	Lulzim Sahiti	Koordinator i Arsimit	044201984	lulzimsahiti@hotmail.com	
10	Feride Rexhaj	Zyrtar financiar në Arsim	044137449	feri.rexhaj@gmail.com	
11	Aziz Sylejmani	Udhëheqës i Personelit	044981387	aziz_sylejmani@hotmail.com	
12	Sami Januzi	Përgjegjës për çështje pronësoro - jiridike	044205977	sami.januzi@hotmail.de	
13	Sherif Sherifi	Udhëheqës i Inspektoratit	044420694	sherifsherifi61@hotmail.com	
14	Albulena Bungu Hoxha	Qendra Sociale	044709794	buli_b_b@hotmail.com	
15	Rexhep Limani	Klubi i Biznesit	044121260	agrocoop@yahoo.com	
16	Adriatik Beqa	Klubi i Biznesit	044228473	archiman_pr@hotmail.com	

GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

17	Shqipe Rexhaj	Shoqata e Bjeshkatarëve	04457225 7	shqipe.rexhaj@gmail.com	
18	Bejadin Rexhepi	Shoqata e Bjeshkatarëve	04420588 2	brex_aral@hotmail.com	
19	Ejup Ismajli	GLV	04420187 6	ejup_ismajli@hotmail.com	
20	Adelina Reshani	Qendra Rinore	044556192	gendrarinoreshtime@mail.com	
21					
22					

FTESA PER PUNETORI

Ftese per pjesemarrje ne Punetori

*Ne kuader te realizimit te projektit "Per Hartimin e projekteve për
3 Zona Turistike*

*Llanisht-Topillë-Devetak, b) Carralevë-Rancë dhe c) Dugë-Karaqicë-
Pjetërshticë, GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS
ju fton te merrni pjese ne Punetorine e organizuar me date 24, 25 ,
26 Mars 2017ne Golem , Hotel Kosmira ne Shqiperi.*

*Nisja behet nga oborri I Komunes dhe per detajet e nisjes ju lutem
kontaktoni Z. Safet Brahimi zyrtar ne Komunen e Shtimes.*

Me respect.

*Ibrahim Krasniqi, Menaxher i Projektit, GDI Eco Arch Cons.
Prishtine, 22.03.2017*

LISTA E PJESEMARRESVE NE TRAJNIM



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**



GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

Ne kuader te Projektit "Per Hartimin e projekteve për 3 Zona Turistike

a) Llanisht-Topillë-Devetak, b) Carralevë-Rancë dhe c) Dugë-Karaqicë-Pjetërshicë

ORGANIZON

TRAJNIMIN PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË 3 ZONAVE TURISTIKE

Data: _____ 2017 Dita _____, Shtime

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Telefoni	E - mail	Nenshkrimi
1	Ibrahim Krasniqi	Menaxher i Projektit	044666217	gdi.shpk@gmail.com	
2	Fadil Millaku	Ekspert i Projektit	039432361	fmillaku@hotmail.com	
3	Gentrit Krasniqi	Ekspert i Projektit	049967543	Genti@gmail.com	
4	Sabri Çerkini	Drejtor për ZHE	044287346	sabri.cerkini@gmail.com	
5	Bashkim Ahmeti	Zyrtar	044142398	ahmeti15@hotmail.com	
6	Safet Brahimi	Zyrtar	044228487	safet.brahimi@hotmail.com	
7	Feride Rexhaj	Zyrtar	044137449	feri.rexhaj@gmail.com	
8	Jetush Rrafshi	Zyrtar	044378554	jrrafshi@hotmail.com	
9	Sherif Sherifi	Zyrtar	044420694	sherifsherifi61@hotmail.com	
10	Rexhep Limani	Klubi i Biznesit	044121260	agrocoop@yahoo.com	
11	Adriatik Beqa	Klubi i Biznesit	044228473	archiman_pr@hotmail.com	
12	Shqipe Rexhaj	Shoqata e Bjeshkatarëve	044572257	shqipe.rexhaj@gmail.com	
13	Shqipe Maksutaj	GLV	044877770	shqiponje.maksutaj@gmail.com	
14	Ejup Ismajli	GLV	044201876	ejup_ismajli@hotmail.com	
15	Hava Qarri	GLV	044326251	havaqarri@hotmail.com	
16	Artan Ndrecaj	GLV	044265731	artan_ndrecaj@hotmail.com	
17	Adelina Reshani	Qendra Rinore	044556192	gendrarinoreshtime@mail.com	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

Ne kuader te Projektit "Per Hartimin e projekteve për 3 Zona Turistike
b) Llanisht-Topillë-Devetak, b) Carralevë-Rancë dhe c) Dugë-Karaqicë-Pjetërshticë

ORGANIZON
TRAJNIMIN PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË 3 ZONAVE TURISTIKE

Data: _____ 2017 Dita _____, Shtime

AGJENDË TRAJNIMI

13:45 – 14.00 **Regjistrimi pjesëmarrësve**

14:00 -16:00 **Turizmi Rural dhe Zvillimi i Qendrueshem**

- *Cfare eshte Turizmi Rural*
- *Cka ndikon Turizmi rural ne zhvillimin ekonomik*
- *Identifikimi dhe klasifikimi i projekteve ne kuader te turizmit rural*
- *Menaxhimi i turizmit rural*
- *Definimi i resurseve te turizmit rural dhe me gjere*
- *Definimi i nevojave dhe projekteve në turizme rural nivel lokal*
- *Përshkrimi i idesë së projekteve locale ne rastin e turizmit rural*
- *Realizimi I listes se projekteve ne rastin perkates*

AGJENDA E TAKIMEVE



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

Ne kuader te Projektit "Per Hartimin e projekteve për 3 Zona Turistike

GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

a) Llanisht-Topillë-Devetak, b) Carralevë-Rancë dhe c) Dugë-Karaqicë-Pjetërshticë

ORGANIZON PUNETORI PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË 3 ZONAVE TURISTIKE

Data:24, 25 dhe 26 Mars 2017
Hotel Kosmira, Golem, Shqiperi

AGJENDA

E Premte 24 Mars 2017	
17.00-17.30	Arritja e participanteve, regjistrimi dhe akomodimi
17.30-17.45	Hapja e Punetorise <ul style="list-style-type: none">Naim Ismajli, Kryetar i Komunes se ShtimesProf.dr. Ibrahim Krasniqi, Manaxher i Projektit, GDI Consult.Sabri Cerkini, Drejtor i departamentit
17.45-19.30	Sesioni i pare Prezentimi i te arriturave te deritashme te projektit projektit dhe objektivat e punetorise
17.30-19.00	Darka
Dita e dyte , E shtune 25 Mars	
8.30-9.30	Mengjesi
9.30 -11.00	Moderator:Ibrahim Krasniqi Tema per diskutim: Turizmi rural, sfidat mundesite dhe zhvillimi ne Komunen e Shtimes
11.00-11.30	Pauza per Kafe
11.30-12.30	Vazhdim diskutimi
12.30-14.00	Dreka
14.00-17.30	Sesioni i dyte Moderator:Ibrahim Krasniqi Tema 2 per diskutim: Mundesite e zhvilimit te turizmit rural ne zonat, a) Llanisht-Topillë-Devetak, b) Carralevë-Rancë dhe c) Dugë-Karaqicë-Pjetërshticë"
17.30-17.45	Konkluzionet e dites
17.45-18.30	Diskutim i lire ne grupe
19.30-21.00	Darka
E diele 26 Mars 2017	
8.30-9.30	Mengjesi

GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

9.30-10.30	<p>Sesioni trete- Moderator Experti Projektit/Komunes</p> <p>Tryeze e rumbullaket-Tema per diskutim:</p> <p>Roli i stakeholdereve ne zhvillimin e turizmit rural ne Komunen e Shtimes</p> <p>a)identifikimi i te gjithe stakeholdereve</p> <p>b)identifikimi i interesave per zonat e permendura turistike</p> <p>c)roli i Komunes ne realizimin e projekteve ne keto zona</p>
10.30-11.00	Pauza per Kafe
11.00-12.30	<p>Sesioni i katert-Moderator:Ibrahim Krasniqi/Fadil Millaku</p> <p>Prezentimi i produktit turistik te zonave</p> <p>Tema per diskutim:</p> <p>Eksperienat dhe idete e partnereve per hartimin e projekteve per tre zonat e permendura te turizmit ne Komunen e Shtimes</p>
12.30-13.00	Konkluzionet e punetorise dhe mbyllja e punimeve
13.00-14.30	<i>Dreka</i>
14.30-14.45	Nisja

KOPJE E BROSHURES NE SHQIP



Si të mbërrini ne Shtime?

Nëpërmjet Ajrit: Ju mund të vini nëpërmjet aeroportit nderkombëtar "Adem Jashari", Prishtinës (23 km) dhe ai i Tiranës (Shqipëri, 207 km duke kaluar nga rruga e kombit).

Nëpërmjet Detit: Ju mund të vini nga porti i Durrësit që është 230 km dhe nga porti i Shengjinit që është 190 km.

Nëpërmjet Tokës: Në Komunën e Shtimes ju mund të vini nga veriu - Prishtina (28 km), nga jugu-Prizreni-52 km, nga perendimi-Peja, 80 km dhe nga veri perendimi-Mitrovica, 00 km. Poashtu Shtimja është shumë lehte për tu arritur edhe nga Shkupi përmes Ferizajit (67 km). Poashtu në të gjitha pozicionet e zonave janë shënuar pikat interesante për turizmin rural dhe atë kulturor, historik e etnografik.



PROFILI YNE-NJË PERSHKRIM I SHKURTER

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshin qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra (134 km²) me një popullsi prej 27,324 banorë me një dendësi popullore 203.91 banorë / km² dhe moshë mesatare 27.62 vjeç. Shtimja ka klimë kontinentale me rreshje mesatare 673 mm në vit dhe temperatura mesatare -1.4 °C në Janar dhe 20.6 °C në Korrik. Në vendbanimet e komunës së Shtimes gjenden gjurmë të trashëgimisë historike e kulturore që prej kohës së neolitit, ilirëve, romakëve dhe të Perandorisë Osmane. Sipas defterit kadastral të vitit 1455 Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrisë dhe ishte nën pushtimin osman. Në vitin 1560-74 i takonte Nahijes së Moravës me qendër në Prishtinë. Ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanjakut të Prizrenit. Komuna Shtime, kufizohet me komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suarekës). Qyteti i Shtimes është 31 km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45 km larg Prizrenit dhe 13 km nga Ferizaj. Është e pasur me shumë bukuri natyrore dhe trashëgimi të shumellojte.



KOMUNA E SHTIMES

Adresa: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës

<http://ik.rks-gov.net/shtime/>

Puna: Dr. Ibrahim Krasniqi

Menaxher Projekti, GDI Shpk, Prishtine

gdi.shpk@gmail.com

mob:+37744606217



Pezgje shqiptare nga "Dhryka e Lirimit"



Ujvarat e Mallapalcit

KOMUNA E SHTIMES

TURIZMI RURAL DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHEM

Adresa: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës .
<http://ik.rks-gov.net/shtime/>



Guri i Shtrenjte- Mbetjet e Kalase

Cfarëofron Komuna e Shtimes per turizëm rural - Trashëgimia kulturore dhe turizmi kulturor

Që nga koha e bronzit, Shtimja ishte e banuar nga popullsia ilire e fisit të dardanëve, të shpërndarë në kala të shumta dhe vendbanime kodrinore e fushore. Në kohën e sundimit të Perandorisë Romake u zhvillua rrjeti i vendbanimeve urbane dhe i rrugëve, të cilat lidheshin me sistemin rrugor të Perandorisë. Ky zhvillim u pasurua ndër vite dhe sot objekte të tilla me vlere numerohen kalatë, kullat e vjetra dhe antikitetet e ndryshme të gjetura në teritorin e Shtimes.



Shtimja e viteve të 50-ta

Drejtimet strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në Shtime

"Komuna e Shtimes krijon mundësi dhe potenciale për zhvillimin e turizmit rural, shfrytëzimin e burimeve natyrore duke ruajtur mjedisin, trashëgimin natyrore, kulturore dhe historike".

Hapat për Zhvillimin e Turizmit Rural në Shtime

- Identifikimi dhe shenjëzimi i shtegjit për ecje dhe ciklizem në gjatësi 7 km Llanisht-Devetak
- Kampanja vetedijesuese për mundësitë që ofron turizmi rural
- Hartimi projekteve për Zonat Turistike
 - Llanisht - Topillë - Devetak,
 - Carralëvë - Rancë dhe
 - Dugë - Karaqicë - Pjetërshiticë
- Identifikimi dhe shenjëzimi i burimeve natyrore, agroturistikë dhe historiko kulturore
- Trajnimi i stafit dhe përfaqësuesve të biznesit për projekte në turizem rural
- Krijimi politikave lehtësuese për investues në fushën e turizmit rural.



Ujvare në grykën e Llanishtit



Spitali Ushtarak i UCK-së



Manifjestimet e Pavarësisë në Shtime



Kompleksi përkujtimor i Recakut

KOPJE E BROSHURES NE ANGLISHT



How to arrive in Shtime?

Through the Air: You can reach Shtime from the international airport "Adem Jashari", Pristina (23 km) and Tirana Airport (Albania, 207 km).

Through the Sea: You can come from the port of Durrës which is 230 km away and from the port of Shengjin which is 196 km distance from Shtime.

Through the Land: In Shtime you can come from the north direction - Pristina (28 km), South-Prizren-45 km, from Peja-Peja, 80 km and north-west Mitrovica, 66 km. Shtime is also easy to be reached from Shkup via Ferizaj (67 km). Also in all the positions of the zones are marked interesting points for rural, cultural, historical and ethnographic tourism.



OUR PROFILE - A BRIEF DESCRIPTION

The municipality of Shtime is located in the central part of Kosovo and includes the city of Shtime and 22 villages (134 km²) with a population of 27,324 inhabitants. The population density is 203.91 inhabitants / km² and an average age of 27.62 years. Shtime has a continental climate with average rainfall of 673 mm per year and average temperature of -1.4 °C in January and 20.6 °C in July. In the settlements of the municipality of Shtime there are traces of historical and cultural heritage since the Neolithic times, Illyrians, Romans and the Ottoman Empire. According to the cadastral deployment of 1455 Shtime belonged to Vilajet of Vushtrri and was under Ottoman invasion. In 1566-74 he belonged to Nahije Morava, based in Pristina. Whereas in the 19th century it belonged to the Sanxhak of Prizren. Municipality of Shtime is bordered by the municipalities of Ferizaj, Lipjan and Theranda (Suhareke). The city of Shtime is 28 km from the capital of Kosovo - Pristina, 45 km from Prizren and 13 km from Ferizaj. It is rich in natural beauty and inheritance.



SHTIME MUNIICIPALITY

Adress: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës
<http://kk.rks-gov.net/shtime/>

Prepared: Dr. Ibrahim Krasniqi
 Project Manager, GDI Shpk, Prishtine
gdi.shpk@gmail.com
 mob:+37744060217



Parqe atraktive nga "Gryka e Lirimit"



Mallapalci Waterfalls

SHTIME
MUNICIPALITY

RURAL TOURISM AND SUSTAINABLE DEVELOPMENT

Adress: Rr. "Tahir Sinani" Nr. 50, 72000, Shtime, Republika e Kosovës.
<http://kk.rks-gov.net/shtime/>



Guri i Shtrenjte- Rests of the Castle

What does Shtime Municipality offer for rural tourism - Cultural heritage and cultural tourism

Since the time of bronze, Shtime was inhabited by the Illyrian population of the Dardanian tribe, scattered in numerous castles and hilly settlements of the plains. During the rule of the Roman Empire, the network of urban settlements and roads, which were linked to the Empire's road system, was developed.

This development was enriched in years and today such valuable objects are numbered Castles, old towers and various antiquities found in the territory of Shtime.



Shtimja e vitave të '50-ta

Strategic directions of sustainable tourism development in Shtime

"Municipality of Shtime creates opportunities and potential for the development of rural tourism, the exploitation of natural resources by preserving the environment, natural, cultural and historical heritage".

Steps for the development of rural tourism in Shtime

- Identification and marking of the walking and cycling path in 7 km length Llanisht-Devetak
- Awareness campaigns on the opportunities offered by rural tourism
- Design projects for Tourist Areas
 - Llanisht - Topillë - Devetak,
 - Carralevë - Rancë and
 - Dugë - Karaqicë - Pjetërshiticë
- Identification and marking of natural, agro-touristic and historical cultural resources
- Training of staff and business representatives for rural tourism projects
- Creating facilitating policies for investment in rural tourism.



Water fall in the Llanisht Valley



Military Hospital of UCK



Independence Day in Shtime



Memorial Complex in Recak

MATERIALET DHE AGJENDA FINALE E TRAJNIMIT



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**



GDI ECO-ARCH CONSULTING & PROJECT PLUS

Ne kuader te Projektit "Per Hartimin e projekteve për 3 Zona Turistike
c) Llanisht-Topillë-Devetak, b) Carralevë-Rancë dhe c) Dugë-Karaqicë-Pjetërshiticë

**ORGANIZON
TRAJNIMIN PERMBYLLES PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË 3 ZONAVE TURISTIKE**

Data: __19.05. 2017_ Shtime

gdi.shpk@gmail.com

Prishtine

AGJENDA E TRAJNIMIT DHE CEREMONIA PERMBYLLESE

9:45 – 10.00 **Regjistrimi pjesëmarrësve**

10:00 -12:00 **Projektet, Menaxhimi i Projekteve ne Turizmin Rural dhe Zvillimi i Qendrueshem**

- *Cfare eshte mundesia e projekteve ne Turizmin Rural*
- *Cka ndikon menaxhimi modern i projekteve ne Turizem rural dhe ne zhvillimin ekonomik*
- *Si ndodh Menaxhimi i turizmit rural*
- *Definimi i resurseve te projektit te turizmit rural dhe me gjere*
- *Si behet vendimmarrja per nje projekt te turizmit rural*
- *Cilat jane kriteret e vendimmarrjes*
- *Si konitorohen projektete turizmit rural*
- *Si menaxhohet stakeholderet e projektit*
- *Si mund te terhiqen grante dhe kredi per projekte te turizmit rural*

12:00 -12:30 **Ceremonia permbyllese dhe shperndarja e certifikatave per pjesemarresit**

MOSTRA E CERTIFIKATES



TERMAT E REFERENCES

Termet e Referencës (TeR)

Për Hartimin e projekteve për 3 Zona Turistike

- a) Llanisht - Topillë - Devetak,
- b) Carralevë - Rancë dhe
- c) Dugë - Karaqicë – Pjetërshticë

I. Sfondi:

Komuna e Shtimes ka aprovuar Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit Rural që është konceptuar dhe do të zbatohet për ruajtjen dhe zhvillimin e rajonit agroturistik të definuar në të. Për të implementuar këtë dokument strategjik Komuna ka paraparë në KAB projekte të ndryshme që do të mbështesin zhvillimin ekonomik në Komunën e Shtimes, duke krijuar ambient të mirë të biznesit dhe zhvillimin e aftësive. Projekti do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, duke krijuar kushte për krijimin e punësimit dhe gjenerimin e të ardhurave dhe duke përmirësuar konkurrueshmërinë e bizneseve ekzistuese. Një nga objektivat e këtij projekti është për të zgjeruar dhe për të përmirësuar infrastrukturën, ngritur vetëdijen dhe kuptuar rolin e turizmit në zhvillim rural.

Zhvillimi i Turizmit Rural në Komunën e Shtimes

Komuna e Shtimes është një nga komunat që krenohet jo vetëm me burimet e bukura natyrore (pamje malore, bimësi të bukur, peisazhe të paprishura), por edhe me një trashëgimi kulturore unike. Strategjia e turizmit rural është hartuar në bashkëpunim mes komunës, biznesit lokal dhe komunitetit dhe në kuadër të saj janë paraparë mundësitë dhe identifikuar vendet e akomodimit dhe shërbimeve të mundshme turistike rurale, vendtërheqjet turistike (shtigje natyrës, hiking, lojëra popullore sportive dhe suvenire). Bazuar në vlerësimin e bëre, është parashikuar që zhvillimi i turizmit rural në zonën e projektit mund të konsiderohet si një mënyrë praktike për arritjen e objektivave të projektit. Kështu, projekti synon të përgatisë një Plan gjithëpërfshirës implementues për tri (3) zona të turizmit dhe duke propozuar një qasje të integruar, ku aspektet që lidhen me zhvillimin, menaxhimin dhe monitorimin e sektorit të turizmit rural do të konfirmojnë rëndësinë që do ketë në të ardhmen kjo fushë. Turizmi i qëndrueshëm përfshin të gjitha format e zhvillimit të turizmit, menaxhimit dhe të veprimtarisë të cilat respektojnë burimet natyrore, kulturore dhe sociale në afat të gjatë, dhe kanë për të kontribuar në mënyrë pozitive dhe të barabartë në zhvillimin dhe mbetjen e individëve që jetojnë, punojnë dhe qëndrojnë në këto zona.

II. Objektivat specifike

Konsulenti/ Kompania konsulente ka për detyrë të përmbush këto objektiva

Hartimin e projekteve detale për 3 Zona Turistike

- a) Llanisht - Topillë - Devetak,
- b) Carralevë - Rancë dhe
- c) Dugë - Karaqicë - Pjetërshticë

III. Procesi i realizimit të projektit - konsulencës

Ky projekt do jetë i ndarë në dy faza. Në fazën e parë që zgjatë nga data orientuese 01.09. 2016 - 31.12.2016 dhe faza e dyte nga 01.01.2017 - 30.06.2017. Paketat e punëve për secilën faze duhet te specifikohen nga Konsulenti bazuar në TeR.

Pas fillimit një takim prezantues do të mbahet në zyrën e Komunës për të shqyrtuar dhe për të siguruar që është arritur pajtueshmëria konform termave të referencës. Përveç kësaj të gjitha marrëveshjet kontraktuale dhe kushtet do të kontrollohen në atë mënyrë që Konsulenti/Kompania do të jetë në gjendje të lehtë të ndjekë procedurat administrative.

Konsulenti/Kompania do të kryejë një rishikim të dokumenteve të projektit, duke përfshirë propozimin e projektit dhe Raportin fillestar. Gjatë kësaj kohe, pyetje e sqarime mund t'i drejtohen Komunës së Shtimes ose stafit të projektit.

Raportimi

- Konsulenti/Kompania do të sigurojë raporte të detajuara të aktiviteteve në baza mujore/tremujore.
- Kompania/Konsulenti do të ofrojë përshkrim të plotë të buxhetit të të gjitha shpenzimeve të përshkruara në specifikacion.

Objektivat dhe Rezultatet.

- Draft Raporti përfundimtar për fazën e parë do të dorëzohet deri në dhjetor të vitit 2016.
- Draft Raporti përfundimtar për fazën e dytë do të dorëzohet deri në qershor të vitit 2017.

Logjistika

- Komuna e Shtimes do të sigurojë një hapësirë për zyre, kompjuter, letër dhe material shpenzues përkatës etj.

Kërkesat

Detyra pritet të fillojë në shtator , 2016 dhe do të përfundojë jo më vonë se 30 gusht 2017.

Rimbursimi i kostove

- Paga do të jetë në bazë të raporteve të punës së kryer dhe pas dorëzimit të faturës duhur.

Konsulenti/Kompania duhet të sigurojë përmbushjen e objektivave të përmendura:

Hartimin e projekteve detale për 3 Zona Turistike

a) Llanisht - Topillë - Devetak,

b) Carralevë - Rancë dhe

c) Dugë - Karaqicë - Pjetërshticë

- *Për secilën zonë duhet përfshirë dizajni dhe zhvillimi i paketave turistike si destinacion turistik*
- *Identifikimi dhe shenjëzimin e burimeve natyrore (ujërat, bimët), atraksioneve natyrore (shpellat, kala, shtëpitë e vjetrat etj.*
- *Identifikimi dhe hapja e shtigjeveshenjëzimi i shtegut me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë (drunjë apo gurë) për ecje në distancë prej 5km*
- *Bën dizajnimin e atraksioneve turistike: shtigje natyrore, hiking, shtigjeve për shëtitje, apo aktivitete të tjera në natyrë*
- *Fletëpalosjet shqip dhe anglisht (përgatitjen,)*
- *Udhëzon modelet e mundshme të agroturizmit / paketa agroturistike*
- *Krijimi i faqeve të internetit për turizëm rural për Komunën e Shtimes*
- *Dizajnimi materialeve për ngritje të vetëdijes agroturistike në Shtime*

Konsulenti/Kompania duhet të ofrojë një deri dy trajnime për zyrtarët komunal të turizmit dhe komunitetin agroturistik në menaxhimin e sektorit agroturistik dhe ndërmarrësis.

IV. Aktivitetet

Aktivitetet kryesore për këtë detyrë mund të përfshijnë (por jo kufizuar në) si vijon:

Faza I: Diagnoza e Sektorit

a) Analiza e situatës

- o Analizimi dhe vlerësimi i trendeve në industrinë e turizmit rural në Shtime
- o Identifikimi i produkteve të turizmit rural dhe përvojat ekzistuese
- o Identifikimi i potencialit për produkte të turizmit rural ne zonat përkatëse
- o Analiza e potencialit për zhvillimin e turizmit në secilën zonë
- o Rishikimi atraksione turistike dhe destinacionet ekzistuese në dhe rreth zonës së projektit

b) Analiza e burimeve humane

- c) Vlerësimi i produktit dhe identifikimi i produkteve kryesore të turizmit rural ne zonat e përmendura
- o Zgjidhni produktet më premtuese të zhvillimit të turizmit të bazuar në vlerësimin paraprak të burimeve dhe konsultimeve me aktorët kryesorë
- o Vlerësimi dhe harta e çdo produkt me një kornizë që përfshin burime, tregun, ndikimin ekonomik dhe kriteret sociale

Faza II: Zhvillimi i Projekteve finale për zonat turistike

a) Llanisht - Topillë - Devetak,

b) Carralevë - Rancë dhe

c) Dugë - Karaqicë - Pjetërshticë

Kjo pjesë e aktiviteteve përfshin

- a) Kryerjen e konsultime të gjera me grupet e interesit në të cilën palëve të interesuara do t'u jepet një mundësi për të kontribuar me mendimet e tyre, komentet dhe sugjerimet për hartimin dhe formulimin e projekteve për çdo zonë.
- b) Plani i Menaxhimit të zonave që duhet të ketë vizion të qartë rreth respektimit të parimeve të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm dhe të sugjerojnë për një mekanizëm institucional për bashkëpunim, koordinim, strategji, zbatim dhe koordinim.
- c) Është parashikuar që Plani duhet të ketë strategji të qarta për - zhvillimin e produkteve, marketingut, ngritjen e kapaciteteve, zhvillimin e infrastrukturës, mbrojtjen e burimeve të turizmit, përfshirjen e komunitetit, etj.
- ç) Vizitë studimore
- d) Projektet finale për tri zonat

V. Raportimi, dokumentet dhe afatet kohore

Nr.	Dokumentet	Afatet kohore
1	Raporti fillestar	1 muaj pas startimit
2	Raportet e punës	Çdo tre muaj
3	Raporti final i fazës së parë	dhjetor 2016
4	Raporti final i fazës së dytë	1 qershor 2017
5	Raporti përmbyllës	30 qershor 2017

VI. Kualifikimet e personelit të Konsulences:

Konsulenti do të sigurojë një ekip ekspertësh me grupe të përshtatshme aftësish, kualifikimin, ekspertizën dhe përkushtimin e nevojshëm për të përmbushur objektivat e kësaj detyre. Në vijim është një listë treguese

e pozicioneve kryesore, kualifikimet e kërkuara dhe përvojën, si dhe inputet tregues gjatë fazave të ndryshme të projektit.

VI. Detajet e kërkesat e personelit kyç janë dhënë më poshtë:

Nr.	Person kyç/ndihmë	Kualifikimi	Eksperiencia
1	Specialist në përgatitje të projekteve - Person kyç	<ul style="list-style-type: none"> • PhD në menaxhim strategjik • Njohja e gjuhës Angleze. • Njohuri të forta të standardeve të BE • Aftësi të forta lehtësimit. • Përvojë të gjerë si një trajner dhe këshilltar. • Pjesëmarrje dhe qasje interaktive në punë konsulencë. • I aftë për të demonstruar aftësitë efektive ndërpersonale. • Ndërtues ekipi. 	Përvojë në fushën politikave publike dhe përvojë në menaxhim të projekteve <ul style="list-style-type: none"> • Përvojë në zhvillimin e dokumenteve strategjike nga fusha e Turizmit rural dhe trajnimin e stafit për fushën e projekteve
2	Specialist arkitekture - person ndihmës	Arkitekt	Eksperiencë në projekte arkitektonike
3	Specialist agroturizmi - person ndihmës	Ekspert në shkenca turistike ose të natyrës	Eksperiencë në fushë të ngjashme
4	Ekspert i IT	Specialist i IT	Eksperiencë në fushe të ngjashme

Parallogaria për Hartimin e projekteve detale për 3 Zona Turistike a) Llanisht - Topillë - Devetak, b) Carralevë - Rancë dhe c) Dugë - Karaqicë - Pjetërshticë

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Shuma në €
1	Hartimin e projekteve detale për 3 Zona Turistike a) Llanisht - Topillë - Devetak, b) Carralevë - Rancë dhe c) Dugë - Karaqicë - Pjetërshticë Përgaditja dhe printimi i 3 nënprojekteve në 3 kopje fizike dhe 1 kopje elektronike.	3 500
2	Dizajni i pakove turistike a) Llanisht - Topillë - Devetak, b) Carralevë - Rancë dhe c) Dugë - Karaqicë - Pjetërshticë	1 300
3	Identifikimi dhe shenjëzimi i burimeve natyrore (ujërat, bimët), atraksioneve natyrore(shpellat) dhe trashigimisë kulturore-	1 000

	historike (kala, shtëpi etj)	
4	Identifikimi i shtigjeve për 3 zonat turistike: a) Llanisht - Topillë - Devetak, b) Carralevë - Rancë dhe c) Dugë - Karaqicë – Pjetërshticë Hapja e shtegut me një gjatësi 5km’ dhe gjerësi b=1.5m. Shenjzimi i shtegut me shenja standarde për turizëm rural dhe pastrimi i shtegut nga drunjët e padëshiruar.	8 999
5	Dizajnimi i fletëpalosjeve në gjuhën zyrtare dhe anglishtme informata. (2x500fletëpalosje)	800
6	Dizajnimi dhe zhvillimi i nenfaqës së internetit për turizëm rural në Komunën e Shtimes për 3 nënzonat: a) Llanisht - Topillë - Devetak, b) Carralevë - Rancë dhe c) Dugë - Karaqicë – Pjetërshticë	1 000
7	Realizimi i kampanjes vetëdijesuese për zonat e lartëpërmendura turistike. Organizimi i 3 kampanjave Organizimi i 5 debateve publike Dizajnimi dhe shpërndarja e materialeve për pjesëmarrësit Shërbimi me pije për pjesëmarrësit Rezervimi i sallës për debat publik dhe kampanjë (5 ditë)	1 500
8	Organizimi i 4 trajnimeve dy ditore për 20 pjesëmarrës (zyrtarë komunal dhe komunitetin agroturistik). Angazhimi i 2 ekspertëve nga menaxhimi i projekteve dhe ndërmarrësi (secili nga 8 dite pune) Përgaditja dhe shpërndarja e çertifikatave për pjesëmarrësit. Rezervimi i sallës Material për trajnim, pije dhe ushqim për pjesëmarrësit.	2 000
9	Punëtori studimore 3 ditore në ndonjë vendrural të rajonit për 20 pjesëmarrës. Në këtë punëtori 3 ditore duhet të sigurohet: Transporti (vajtje-ardhje) Akomodimi dhe ushqimi Materialet për punëtori Angazhimi i një eksperti të kësaj fushe.	2 900
	Gjithsej:	22 999 (njetzet e dymije e nenteqind e nentedhjetë e nente)

Çmimet duhet të jen të kalkuluara me TVSH.